



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam

Department of Economy, Development and Tourism

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 2569 Më 14.07.2026
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

DATE/A:	06/07//2026
PËR/ZA/TO :	Altin Zhuniqi, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
NGA/OD/FROM:	Spektori për Regjistrimin e Pasurive
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti Vjetor 2025 mbi Menaxhimin e Pasurive të Komunës së Rahovecit

Ky raport paraqet rezultatet e procesit të regjistrimit dhe inventarizimit të pasurive komunale të Komunës së Rahovecit për vitin 2025, të realizuar nga Spektori për Regjistrimin e Pasurive në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

Raporti është hartuar në përputhje me rregulloret dhe procedurat në fuqi dhe bazohet në të dhëna zyrtare të verifikuara, të evidentuara në sistemet përkatëse të menaxhimit të pasurive komunale. Qëllimi i këtij raporti është informimi institucional mbi gjendjen aktuale të pasurive komunale, si dhe ofrimi i një baze të saktë për menaxhimin, planifikimin dhe vendimmarrjen lidhur me asetet komunale.

Me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 6696, datë 06.11.2025, është formuar Komisioni për Regjistrimin e Aseteve Komunale. Komisioni ka realizuar procesin e regjistrimit të pasurive në administratën komunale, institucionet arsimore, si dhe në QKMF dhe AMF.

Në raportin përfundimtar të komisionit është konstatuar se numri i përgjithshëm i asetëve komunale jo-financiare të regjistruara për vitin 2025 është **31,844 asetë**, të shpërndara si vijon:

- Administrata Komunale, objektet kulturore dhe sportive: **7,423 asetë**
- Institucionet arsimore (shkollat): **21,629 asetë**
- QKMF dhe AMF: **2,792 asetë**

Ndërsa sa i përket regjistrimit të pasurive financiare kapitale, janë evidentuar gjithsej:

- Objekte komunale **138** (Nga gjithsej 138 objekte komunale të evidentuara, 44 objekte janë në shfrytëzim dhe të dhëna me qira, 6 objekte janë të dëmtuara dhe jashtë funksionit dhe 88 objekte janë funksionale).
- Vetura **56** (Sa i përket veturave komunale, nga gjithsej 56 vetura, 52 vetura janë në përdorim dhe 4 vetura janë jashtë përdorimit).
- Ngastra të tokave **2,366** (2,347 ngastra nuk janë të dhëna me qira dhe 19 ngastra janë të dhëna me qira).

1. Inventarizimi i Pasurive Komunale

Me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 6695, datë 06.11.2025, është formuar Komisioni për Inventarizimin e Pasurive Jo-Kapitale dhe Kapitale. Procesi i inventarizimit është realizuar në të gjitha njësitë organizative të komunës dhe ka përfshirë verifikimin e gjendjes faktike të aseteve.

Në Administratën Komunale janë inventarizuar gjithsej **7,423 asete**, prej të cilave:

- **7,303 asete** janë në përdorim
- **120 asete** janë jashtë përdorimit

Në institucionet arsimore janë inventarizuar **21,629 asete**, prej të cilave:

- **20,983 asete** janë në përdorim
- **646 asete** janë jashtë përdorimit

Në QKMF dhe AMF janë inventarizuar **2,792 asete**, prej të cilave:

- **2,764 asete** janë në përdorim
- **28 asete** janë jashtë përdorimit

Në total, nga procesi i inventarizimit është konstatuar se, **31,050 asete** janë në përdorim dhe **794 asete** janë jashtë përdorimit.

2. Regjistrimi i Pasurive me Vlerë nën 1,000 €

Lidhur me regjistrimin e pasurive me vlerë më të vogël se **1,000 €**, sipas kodeve të pasurisë, të regjistruara për periudhën **2000–2025** në sistemin **E-Pasuria**, janë evidentuar pasuri kapitale të ndara sipas nënkategorive përkatëse.

Nr.	Kodi i Pasurisë	Përshkrimi	Vlera në Libër (€)
1	13501	Mobilje	82,489.95
2	13503	Pajisje të Teknologjisë Informativë (TIK)	53,223.28
3	13506	Pajisje Mjekësore	29,938.05
4	13509	Pajisje të Tjera	24,671.71
		Gjithsej	190,322.99

(Tabela 1: Detajet e Raportit të Pasurive Kapitale me vlerë nën 1,000 €)

3. Regjistrimi i Pasurive me Vlerë mbi 1,000 €

Sa i përket regjistrimit të pasurive me vlerë mbi **1,000 €**, sipas klasave të pasurisë, për periudhën **2000–2025**, të dhënat janë regjistruar dhe përditësuar në sistemin **SIMFK**. Në vijim paraqiten të dhënat mbi pasuritë e regjistruara në sistemin **SIMFK**, sipas emërimit, vlerës dhe përqindjes përkatëse.

Nr.	Emërtimi i pasurisë	Klasat e pasurive	Vlera fillestare (€)	Zhvlerësimi (€)	Vlera Neto (€)
1	Objekte Arsimore	31121	20,265,277.00	5,161,576.17	15,103,700.83
2	Objekte Sportive	31124	2,568,908.00	440,972.88	2,127,935.12
3	Objekte Kulturore	31123	3,282,382.00	809,549.85	2,472,832.15
4	Vetura ndihmë e shpejtë	31703	394,194.00	262,480.10	131,713.90

5	Paisje speciale njekësore	31660	78,488.00	78,488.00	0.00
6	Objekte Shëndetsore	31122	5,926,523.00	1,440,379.15	4,486,143.85
7	Kapital tjera	31900	1,307,606.00	870,012.72	437,593.28
8	Kamion	31710	72,696.00	72,147.49	548.51
9	Kanalizimi	31250	3,630,344.65	1,126,649.49	2,503,695.16
10	Ndërtimi i rrugëve	31200	649,962.00	327,548.28	322,413.72
11	Tokat	32100	75,104,323.90	0.00	75,104,323.90
12	Paisjet tjera	31690	215,874.00	115,122.61	100,751.39
13	Ujësjiellës	31400	1,650,004.00	494,761.80	1,155,242.20
14	Trotuaret	31240	914,059.00	252,167.29	661,891.71
15	Ndërtimi i rrugëve lokale	31230	14,107,172.00	4,850,486.60	9,256,685.40
16	Ndërtesat banesore	31110	10,105,584.00	3,236,234.13	6,869,349.87
17	Ndërtimi i rrugëve Regionale	31220	607,355.00	365,805.06	241,549.94
18	Investimet në vijim	32500	16,651,013.00	0.00	16,651,013.00
19	Veturat zyrtare	31706	387,819.00	387,819.00	0.00
20	Automjet transporti	31700	8,716.00	8,716.00	0.00
21	Furnizim me rrymë- gjenerator	31510	21,480.00	11,248.69	10,231.31
22	Struktura tjera	31130	2,487,141.00	295,251.92	2,191,889.08
23	Ndërtesa e administratës afariste	31120	8,936,679.00	2,718,421.81	6,218,257.19
24	Paisjet e Ndriqimit publik	32111	1,026,512.00	866,833.36	159,678.64
25	Pasuri e paprekshme	32200	313,001.00	140,562.20	172,438.80
26	Monumente dhe komplekse Memorial	31125	367,287.00	26,247.16	341,039.84
27	Shtreterve te lumenjve	32110	1,559,435.00	159,000.15	1,400,434.85
28	Parqet Nacionale	32120	231,110.00	0.00	231,110.00
29	Rrethoja Metali	31135	9,795.00	9,795.00	0.00
30	Instalimet Hidrosanitare	31300	6,488.00	389.34	6,098.66
31	Paisje te ndryshme	31511	1,394,805.00	261,034.23	1,133,770.77
32	Parqet lokale	32140	1,004,765.00	0.00	1,004,765.00
33	Tregjet Komunale	31132	324,156.00	128,395.10	195,760.90
34	Kendi i Lojrave	32150	98,212.00	49,106.05	49,105.95
35	Fusha Sportive te Hapura	31129	81,727.00	34,507.04	47,219.96
36	Paisje Trafiku	31691	99,140.00	71,601.10	27,538.90
37	Fusha Sportive te Mbyllura	31137	81,996.00	1,195.77	80,800.23
Totali			175,972,029.55	25,074,505.54	150,897,524.01